

Nga inspektimi i kryer rezultoi si më poshtë:

Në këtë institucion rezidencial strehohen të moshuar duke filluar që nga mosha 60 vjeç si dhe të moshuar me probleme të rënda shëndetësore (8 të moshuar), të cilët kërkojnë kujdes të veçantë.

Aktualisht strehoheshin 49 të moshuar, nga 50 që është kapaciteti. Gjithsashtu janë transferuar dy të moshuar nga Shtëpia e të Moshuarve Shkodër deri në përfundim të rikonstruksionit të godinave.

Personeli përbëhet nga 15 punonjës, të cilët kishin dosjet e tyre personale me kualifikimet përkatëse, kopje e të cilave mbahet në institucion. Katër punonjës punojnë me kohë të pjeshme: një mjek, dy kujdestare dhe një sanitare). Me problemet psiko-sociale merren një punonjëse sociale dhe një psikologe. Përshkrimi i punës së tyre pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme të institucionit, e cila është e miratuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Vlerësimi i punës për personelin bëhet dy herë në vit.

Stafi është i trajnuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional për dhënien e ndihmës së shpejtë, ku pas ndjekjes së një kursi 4-mujor janë pajisur me çertifikata.

Shërbimi mjekësor realizohet nga një mjek me kohë të pjesshme që prej 20 vitesh dhe infermieret. Infermierja kryen ndarjen e medikamenteve. Ka një fond shtesë për to, të cilat nuk janë të rimbursueshme. Për marrjen e medikamenteve kishte një formular, i cili firmosej nga personeli dhe i moshuari.

Vizitat dentare bëhen individualisht, me shpenzimet e tyre dhe jo me fondet e institucionit.

Kuota ushqimore ditore për çdo të moshuar është 300 lekë dhe sipas drejtueses së këtij institucioni kjo kuotë është e mjaftueshme për to. Edhe nga takimi me të moshuarit, të cilët po konsmonin vaktin e drekës, nuk paraqitën ankesa për ushqimin. Kampionët e ushqimeve ruheshin në frigorifer. Merret mendimi i të moshuarve për përcaktimin e menisë së ushqimit dhe vakteve të ngrënies. Menuja javore firmoset edhe nga një i moshuar, e cila mund edhe të ndryshohet po nga të moshuarit sipas preferencave.

Furnizimi me artikujt hotelerikë realizohet me blerje nga institucioni.

Duhet theksuar fakti se ambjentet e këtij institucioni ishin në kushte shumë të mira, ku mbizotëronte pastërtia. Të gjitha ambjentet ishin të arregduara dhe komode për të moshuarit, me shumë kënde për të pushuar. Në sallën e aktiviteteve, ka një bibliotekë, televizor, ku të moshuarit mund të kalojnë një pjesë të kohës në mënyrë të kulturuar.

Në ambiente të veçanta ishin vendosur standartet që duhet të respektonin punonjësit e qendrës.

Kutia e ankesave hapet një herë në muaj. Çelësi i saj mbahet nga një punonjës i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë.

Mjetet për shmangjen e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të ndryshme nëpër ambjentet e institucionit. I gjithë stafi është i trajnuar për përdorimin e fikseve të zjarrit.

Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes realizohet me kaldajë, i cili funksiononte. Përdoret me orare të caktuara duke u alternuar me ngrohje me kaldajë dhe në disa dhoma me kondicionerë.

Organizohen aktivitete të ndryshme, festat fetare, festat zyrtare, ditëlindje, etj, brenda institucionit. Aktivitetet rezlizohen me anë të donacioneve të ndryshme.

Të moshuarit vizitohen nga të afërmit e tyre dhe ka një regjistër të veçantë, ku evidentohen këto takime. Për të moshuarit që nuk kanë kontakte me të afërm, është bërë një punë e madhe nga stafi për të bërë të mundur kontaktimin e tyre. Aktualisht, por punohet për të realizuar kthim në familje të një të moshuari.

Monitorimi i standarteve kryhet një herë në vit nga Shërbimi Social Shtetëror, nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, etj.

Ka një marrëveshje me PNUD-in për periudhën Nëntor 2016-Nëntor 2017, ku janë punësuar 3 infermiere. Pas përfundimit të projektit, dy nga infermieret do të punësoheshin në këtë institucion rezidencial. Është bërë kërkesë në Shërbimin Social Shtetëror për shtesë në organikë dhe nuk është kthyer përgjigje. Për këtë qëllim projekti është shtyrë deri në Shkurt 2018.

Nga biseda e bërë me disa nga të moshuar të kësaj qendre, nga ana e tyre u shpreh mirënjohja dhe falenderimi për përkushtimin në punë të stafit të këtij institucioni. Nuk u paraqitën ankesa ndaj stafit. Ato u shprehën se çdo gjë që kërkojmë na plotësohet. Çdo të enjte bëhet mbledhje, ku të moshuarit shprehin shqetësimet e tyre.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan problematikat e mëposhtme:

1. Nuk ka roje objekti. Gjatë ditës ky shërbim kryhet nga vetë të moshuarit, ndërsa gjatë orëve të natës kryhet nga vetë stafi.
Siç jemi shprehur edhe në rekomandimet e dërguara pas inspektimit në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, kostoja financiare për roje private është më i lartë sesa shtimi në organikë me roje objekti. Për vetë specifikën e institucionit, roja duhet të jetë jo vetëm për ruajtjen e objektit, por edhe për mënyrën e komunikimit me të moshuarit, me vizitorët etj, sepse roja private ndryshon çdo vit kur kryhet prokurimi. **Do të sugjeronim që ky shërbim të kalonte nga zëri 602 “Shpenzime operative” në zërin 600 dhe 601 “fond pagash dhe sigurime shoqërore.”**
2. Në këtë institucion, strehohen të moshuar, të cilët janë me probleme të rënda shëndetësor, gjë që bëhet pengesë për një jetesë normale të të moshuarve.
3. Një problem shqetësues që ende ka mbetur pa zgjidhje, është mungesa e një automjeti, i cili është i rëndësishëm për transportin e të moshuarve. Aktualisht, ka një kontratë me shërbimin “taxi”, ku është lidhur një marrëveshje për t’i transportuar të moshuarit në qendrat shëndetësore. Por çdo muajt e moshuarit kanë vizitat e tyre mjekësore. Përpos kësaj vendosja e një automjeti është i rëndësishëm edhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme, jashtë institucionit dhe kjo kërkon shpenzime.
4. Nga inspektorët e Shërbimit Social Shtetëror është lënë detyrë që në turnin e tretë të këtë dy kujdestarë, por kjo është e papërbalueshme për shkak të organikës jo të plotë. Aktualisht janë 7 (shtatë) kujdestarë, ku 5 luajnë rolin e infermierit dhe 2 të tjerë (1 magazinier dhe 1 kryeinfermier).

5. Në buxhet nuk ka një zë të veçantë për zhvillimin e aktiviteteve të institucionit.

Sa më lart, për të plotësuar standartet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË

1. Shtim në organikë me: infermierë, roje objekti, psikiatër.
2. Gjetjen e mundësive për vendosjen e një automjeti.
3. Të shihet mundësia, që brenda buxhetit të këtij institucioni, zhvillimi i aktiviteteve të jetë si “zë” më vehte.
4. Sistemimin e të moshuarve, të cilët janë me probleme të rënda shëndetësore në një qendër të përshtashmë për to.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se, *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI